

**LIGJI NR. 03/L-049**

**PËR FINANCAT E PUSHETIT LOKAL**

Në mbështetje të Kapitullit IV neni 65 pika 1 si dhe Kapitullit X neni 124 pika 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke njohur nevojën për përcaktimin e burimeve financiare të cilat janë në dispozicion të komunave në Kosovë, duke përfshirë të hyrat vetanake komunale, grantet dhe burimet e tjera financiare të nevojshme për ushtrimin e kompetencave komunale,

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJIN PËR FINANCAT E PUSHETIT LOKAL**

**PËRMBAJTJA**

**PJESA I**

**Dispozitat e përgjithshme**

Neni 1	Përkufizimet
Neni 2	Pavarësia Financiare e Komunave
Neni 3	Kufizimet në Pavarësinë Financiare të Komunave
Neni 4	Kompetencat Vetanake
Neni 5	Kompetencat e Deleguara
Neni 6	Kompetencat e Shtuara

**PJESA II**

**Burimet Financiare Komunale**

**KREU I**

**Të Përgjithshme**

Neni 7	Burimet Financiare Komunale
Neni 8	Kategoritë e të Hyrave Vetanake

**KREU II**

**Taksat Komunale**

Neni 9	Taksa në Pronën e Paluajtshme
Neni 10	Taksa për Lejen për Ushtrimin e Veprimtarisë Afariste
Neni 11	Taksa për Lejen për Shërbime Profesionale
Neni 12	Taksa për Automjetet Motorike
Neni 13	Taksat Administrative Komunale
Neni 14	Taksat për Lejet për Ndërtimin dhe Rrënimin e Ndërtesave dhe Strukturave të Tjera
Neni 15	Taksat tjera Komunale
Neni 16	Taksat për Lëshimin e Certifikatave dhe Dokumenteve Zyrtare

**KREU III**

**Taksat, Rentat, Gjocat, Bashkë pagesat dhe të hyrat e Tjera Vetanake Komunale**

Neni 17	Tarifat Rregullative për Zhvillimin ose Ruajtjen e Infrastrukturës
Neni 18	Gjocat në Trafik

Neni 19	Gjohet për Shkeljen e Rregulloreve Komunale
Neni 20	Të hyrat nga qiradhënia
Neni 21	Bashkë pagesat për Arsim dhe Shëndetësi
Neni 22	Të hyrat e tjera vetanake

**PJESA III                    Gratet Operative dhe për Barazim**

Neni 23	Grantet Operative
Neni 24	Granti i Përgjithshëm
Neni 25	Grantet Specifike për Arsim dhe Shëndetësi

**PJESA IV                    Grantet dhe Transferet e Tjera**

Neni 26	Transferet për Kompetencat e Deleguara
Neni 27	Grantet për Kompetencat e Shtuara
Neni 28	Autorizimi për Shpenzim dhe Monitorimi
Neni 29	Grantet e Jashtëzakonshme

**PJESA V    Huamarrja Komunale dhe Zotimet**

Neni 30	Huamarrja Komunale dhe Zotimet Afat-Gjate
---------	---

**PJESA VI                    Dispozitat Institucionale dhe Komisioni i Granteve**

Neni 31	Dispozitat mbi Grantet Operative
Neni 32	Komisioni i Granteve: Anëtarësia, Organizimi, Takimet
Neni 33	Komisioni i Granteve: Përgjegjësitë

**PJESA VII                    Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare**

Neni 34	Grantet Minimale për VF 2009
Neni 35	Shfrytëzimi i të dhënave të reja mbi popullsinë
Neni 36	Zbatimi, Aktet Nënligjore
Neni 37	Hyrja në Fuqi

**PJESA I  
Dispozitat e Përgjithshme**

**Neni 1  
Përkufizimet**

1.1 Me qëllim të interpretimit dhe zbatimit të këtij ligji – termet dhe shprehjet në vijim – kurdo që përdoren në këtë ligj - kanë kuptimin e përcaktuar më poshtë, përveç nëse konteksti në të cilin këto terme ose shprehje përdoren, qartësisht ka kuptim tjetër:

-“**Ndarje Buxhetore**”- do të thotë identifikimi i shumës maksimale të përcaktuar në një Ligj për Ndarjet Buxhetore të miratuar nga Kuvendi i Kosovës e cila mund të vihet në dispozicion për shpenzim nga një organizatë buxhetore gjatë vitit fiskal për shpenzim në një program të caktuar ose kategori tjetër

shpenzimi ose për bartje nga një organizatë buxhetore te një autoritet publik ose ndërmarrje publike në formë të grantit.

-**“Kuvendi”**- do të thotë Kuvendi i Republikës së Kosovës.

-**“Karta Evropiane”**- do të thotë Kartën Evropiane për Vetëqeverisje Lokale të miratuar nga Këshilli i Evropës me 15 Tetor 1985.

-**“Zyrtari Kryesor Financiar” ose “ZKF”**- ka kuptimin e përcaktuar në LMFPF.

-**“Kompetencat e deleguara”**- do të thotë kompetencat komunale të përcaktuara në Nenin 18 të LVQL.

-**“Kompetencat e shtuara”**- do të thotë kompetencat komunale të përcaktuara në nenin 19 të LVQL.

-**“Taksë”**- do të thotë një shumë fikse e cila paguhet për pranimin e një privilegji, leje, dokumenti ose shërbimi profesional. Taksat zbatohen për licenca, leje, dokumentet, shërbime të caktuara ose nevoja të tjera për përmbushjen e të cilave nuk ka shumë ndryshim në masën e përpjekjeve, kohën ose materialet e nevojshme.

-**“Gjobë”**- do të thotë një pagesë e cila duhet të bëhet në rast të shkeljes së një ligji, rregulle ose rregullore komunale. Në përgjithësi, gjobat shqiptohen me qëllim të dënimit të një shkelje dhe duhet të shqiptohen në përputhje me shumatat e përcaktuara në skemat fikse të cilat zbatohen për shkeljet e legjislacionit komunal.

-**“Viti fiskal”**- do të thotë periudhën prej 1 Janarit të një viti deri më 31 Dhjetor të të njëjtit vit;

-**“Rregullat KMF”**- nënkupton Rregullat e Kontrollit dhe Menaxhimit Financiar dhe ka kuptimin e përcaktuar në LMFPF.

-**“Grant i Përgjithshëm”**- do të thotë një shumë e cila i ndahet një komune dhe e cila mund të përdoret nga komuna për çfarëdo qëllimi që ndërlidhet me kompetencat e saj.

-**“Qeveria”**- nënkupton Qeverinë e Republikës së Kosovës.

-**“Komisioni i Granteve”** - ka kuptimin dhe funksionet e përcaktuara në nenet 33 dhe 32 të këtij ligji;

-**“Regjistri i Bizneseve të Kosovës”**- nënkupton Regjistrin e Kosovës për Shoqëritë Tregtare dhe Emrat Tregtar.

-**“Buxheti i Konsoliduar i Kosovës” ose “BKK”**- do të thotë buxhetin gjithë përfshirës të Kosovës për të gjitha organizatat buxhetore.

-**“Fondi i Konsoliduar i Kosovës” ose “FKK”**- nënkupton fondin i cili fillimisht është themeluar në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut 1999/16, (me ndryshim-plotësime), ose llogaritë apo grupin e konsoliduar të llogarive të përcaktuar më hollësisht në Regjistrin Kontabël të Thesarit me qëllim të depozitimit ose pagimit të parave publike, si dhe interesit të mbledhur.

-**“LMFPF”**- nënkupton Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

-**LVQL**- nënkupton Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale.

-**“Vetëqeverisja Lokale”**- ka kuptimin e përcaktuar në LVQL.

-**“Kryetari i Komunës”**- ka kuptimin e përcaktuar në LVQL.

**“KAMSH” ose “Korniza Afat Mesme e Shpenzimeve”**- ka kuptimin e përcaktuar në LMFPF.

-**“Kuvendi Komunal”**- ka kuptimin e përcaktuar në LVQL.

- “**Kompetencat Komunale**”- do të thotë kompetencat komunale të përcaktuara në nenin 16 të LVQL.
- “**Kompetencat Vetanake**”- do të thotë kompetencat komunale të përcaktuara në nenin 17 të LVQL.
- “**Rregullore Komunale**”- ka kuptimin e përcaktuar në LVQL.
- “**Komuna**”- ka kuptimin e përcaktuar në LVQL.
- “**Prona komunale**”- nënkupton pronën, duke përfshirë pronën e paluajtshme, e cila është ligjërisht në pronësinë ose ligjërisht nën administrimin e komunës.
- “**Llogari zyrtare bankare**”- ka kuptimin e përcaktuar në LMFP.
- “**Grant Operativ**”- është term i përgjithshëm i cili përfshin një Grant të Përgjithshëm, një Grant Specifik për Arsim dhe një Grant Specifik për Shëndetësi.
- “**Të hyrat vetanake**”- do të thotë të gjitha shumat e parave publike të cilat janë shqiptuar dhe janë mbledhur në mënyrë të ligjshme nga komuna nga burimet e përcaktuara në Nenin 8 të këtij ligji.
- “**Person**”- do të thotë një person fizik ose një ndërmarrje.
- “**Ndërmarrje publike**”- ka kuptimin e përcaktuar në LMFP.
- “**Rregullorja e Punës**”- ka kuptimin e përcaktuar në LVQL.
- “**Grant Specifik për Arsim**”- do të thotë një shumë e cila i ndahet një komune dhe e cila mund të përdoret nga komuna vetëm për arsim.
- “**Grant Specifik për Shëndetësi**”- do të thotë një shumë e cila i ndahet një komune dhe e cila mund të përdoret nga komuna vetëm për shëndetësi.
- “**LLVTH**” ose “**Llogaria e Vetme e Thesarit**”- ka kuptimin e përcaktuar në LMFP.
- “**Ndërmarrje**”- do të thotë çdo organ, themelatë, institucion, shoqatë, ndërmarrje, shoqëri tregtare, person juridik, ose organizatë tjetër; dhe
- “**UNMIK**”- nënkupton Misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë.

1.2 Referencat në këtë ligj ndaj ligjeve ose rregulloreve të tjera duhet të interpretohen për të përfshirë të gjitha ndryshimet dhe plotësimet ose legjislacionin pasues të tyre.

## **Neni 2 Pavarësia Financiare e Komunave**

2.1 Në përputhje me politikat ekonomike kombëtare dhe duke pasur parasysh qëndrueshmërinë fiskale të komunave dhe Qeverisë, Komunat e Kosovës kanë të drejtë të kenë burime të mjaftueshme financiare me të cilat mund të disponojnë lirshëm gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre komunale në përputhje me ligjet e zbatueshme të Kosovës.

2.2 Burimet financiare komunale do të jenë të barasvlershme me kompetencat komunale të përcaktuara në Kushtetutë dhe në LVQL.

2.3 Për të mirë të popullsisë së komunës, Kuvendi komunal dhe zyrtarët ekzekutiv kanë të drejtën dhe autorizimin që në mënyrë të pavarur t'i rregullojnë dhe menaxhojnë burimet financiare të cilat rrjedhin nga të hyrat vetanake komunale ose të cilat i janë ndarë komunës në formë të grantit të përgjithshëm.

### **Neni 3**

#### **Kufizimet në Pavarësinë Financiare të Komunave**

Me përjashtim të tatimit në pronën e paluajtshme brenda kufijve të saj, komuna nuk është e autorizuar që të caktojë, vjelë ose mbledhë çfarëdo detyrime ose taksa të tjera. Kjo ndalesë vlen (mirëpo nuk kufizohet) për detyrimet doganore dhe detyrimet e tjera, tatimin në të ardhurat e personave, tatimin në vlerën e shtuar, akcizën, tatimin në kapital si dhe të gjitha detyrimet e tjera të cilat kanë ndikim të barasvlershëm me detyrimet dhe taksat e sipërpërmendura; megjithatë, kjo ndalesë nuk zbatohet kur komuna vepron për ushtrimin ose përmbushjen e një funksioni ose përgjegjësie e cila i është deleguar në mënyrë formale dhe të ligjshme nga Qeveria.

### **Neni 4**

#### **Kompetencat Vetanake**

Parimi i pavarësisë financiare të komunave do zbatohet kundrejt financimit dhe zbatimit të kompetencave vetanake komunale; megjithatë, financimi dhe ushtrimi i këtyre kompetencave duhet të bëhet në të mirë të popullsisë së komunës dhe në përputhje me standardet dhe kushtet e aplikueshme për këto kompetenca të përcaktuara me ligj.

### **Neni 5**

#### **Kompetencat e Deleguara**

Kur Qeveria i delegon një kompetencë një ose më shumë komunave, këto komuna, aq sa është e mundshme, mund ta përshtatin ushtrimin e këtyre kompetencave me kushtet lokale. Komuna duhet t'i ofrojë shërbimet të cilat rrjedhin nga një kompetencë e deleguar në mënyrë të hapur dhe të barabartë. Ministri i Ekonomisë dhe Financave, Qeveria dhe Kuvendi duhet të sigurojnë që në BKK komunave t'u ofrohen fondet e nevojshme për ushtrimin e kompetencave të deleguara; këto fonde duhet të jenë në një nivel të mjaftueshëm për mbulimin e shpenzimeve të arsyeshme të komunës të bëra në lidhje me ushtrimin e këtyre kompetencave.

### **Neni 6**

#### **Kompetencat e Shtuara**

Kur një ligj u jep kompetenca të shtuara vetanake një grupi të caktuar të komunave (kompetencat e "shtuara" vetanake), këto kompetenca të shtuara duhet të trajtohen në mënyrë të njëjtë me kompetencat e tjera vetanake. Ministri i Ekonomisë dhe Financave, Qeveria dhe Kuvendi duhet të sigurojnë që në BKK, komunave përkatëse t'u ndahen fondet e nevojshme për ushtrimin e këtyre kompetencave. Nëse në kuadër të një kompetence të shtuar parashihet ofrimi i një shërbimi publik, fondet e ndara për komunën duhet të jenë të mjaftueshme për t'i lejuar komunës ofrimin e këtyre shërbimeve në përputhje me standardet minimale të cilësisë dhe sasisë, të cilat janë përcaktuar në rregullat përkatëse të autoritetit qendror publik i cili është përgjegjës për ofrimin e këtyre shërbimeve në Kosovë; dhe, këto fonde duhet të ndahen në një nivel të mjaftueshëm për mbulimin e shpenzimeve të arsyeshme të komunës të bëra gjatë ushtrimit të këtyre kompetencave.

## **PJESA II**

### **Burimet Financiare Komunale**

#### **KREU I**

##### **Të Përgjithshme**

## **Neni 7**

### **Burimet Financiare Komunale**

7.1 Burimet financiare të një komune përbëhen nga (i) të hyrat vetanake të komunës të përcaktuara në Nenin 8 të këtij ligji, (ii) grantet operative, (iii) grantet për kompetencat e shtuara, (iv) transferet për kompetencat e deleguara, (v) grantet e jashtëzakonshme, (vi) ndihma financiare nga Republika e Serbisë, dhe (vii) të hyrat nga huamarrjet e komunës.

7.2 Komunat duhet t'i zbatojnë dispozitat e aplikueshme të LMFPF gjatë disponimit me këto burime financiare.

## **Neni 8**

### **Kategoritë e të Hyrave Vetanake**

Të gjitha të hyrat e mbledhura ose të pranuar nga komuna në bazë të autorizimit të një ligji nga burimet në vijim, janë të hyra vetanake të komunës:

- a) taksat komunale, gjobat, tarifat e shfrytëzimit, pagesat e tjera për shërbimet publike të ofruara nga komuna si dhe detyrimet rregullatore dhe gjobat e autorizuar në bazë të këtij ligji;
- b) qiratë në pronat e paluajtshme të cilat ndodhen në komunë dhe të cilat janë nën administrimin ose në pronësi të komunës;
- c) të hyrat nga shitja e pasurive komunale;
- d) të hyrat nga ndërmarrjet të cilat janë plotësisht ose pjesërisht në pronësi të komunës;
- e) bashkëpagesat nga konsumatorët e shërbimeve arsimore dhe shëndetësore të cilat ofrohen nga komuna;
- f) të hyrat e realizuara nga cilado agjenci, departament ose organizatë e komunës si rezultat i ofrimit të çfarëdo malli ose shërbimi;
- g) interesi në depozitat komunale, nëse ekziston;
- h) grantet dhe/ose donacionet nga qeveritë e huaja (përveç ndihmës financiare nga Republika e Serbisë) ose nga organizatat e jashtme, duke përfshirë organizatat qeveritare dhe jo-qeveritare si dhe institucionet ndërkombëtare dhe multinacionale.
- i) të gjitha kategoritë e tjera të të hyrave të cilat janë përcaktuar si të hyra vetanake komunale në bazë të një ligji të Republikës së Kosovës.

## **KREU II**

### **Taksat dhe Tarifat Komunale**

## **Neni 9**

### **Taksa në Pronën e Paluajtshme**

Komuna është e autorizuar që të mbledhë tatimin në pronat e paluajtshme të cilat ndodhen brenda kufijve të saj në përputhje me Rregulloren e UNMIK-ut 2003/29.

## **Neni 10**

### **Taksa për Lejen për Ushtrimin e Veprimtarisë Afariste**

10.1 Përmes një rregulloreje komunale, komuna mund të kërkojë nga shoqëritë tregtare (bizneset) të cilat tashmë janë të regjistruara në Regjistrin e Bizneseve të Kosovës që të marrin leje për ushtrimin e veprimtarisë afariste në lokalet të cilat ndodhen brenda komunës ("leja për ushtrimin e veprimtarisë afariste"). Lejet për shoqëritë tregtare të cilat ofrojnë shërbime profesionale nga lokalet të cilat ndodhen brenda komunës rregullohen në bazë të nenit 11 të këtij ligji dhe jo në bazë të këtij neni.

10.2 Përmes një rregulloreje komunale, komuna mund të përcaktojë një taksë vjetore e cila duhet të paguhet nga shoqëritë e regjistruara tregtare për marrjen ose mbajtjen e lejes për ushtrimin e veprimtarisë afariste. Rregullorja e sipërpërmendur mund të vendosë një skemë tarifore e cila përcakton taksa të ndryshme për kategoritë e ndryshme të veprimtarive afariste. Të gjitha taksat për marrjen e lejes

për ushtrimin e veprimtarisë afariste duhet të caktohen vetëm në bazë të rregullave të përcaktuara në rregulloren komunale. Skema tarifore dhe rregullat nuk duhet të përcaktojnë taksa të ndryshme për shoqëritë tregtare të cilat ushtrojnë veprimtari të njëjtë ose të ngjashme afariste.

10.3 Rregullorja e sipërpërmendur komunale mund të përcaktojë taksa të ndryshme për marrjen e lejes për ushtrimin e veprimtarisë në bazë të:

- a) kategorisë së veprimtarisë afariste, si p.sh. shitja me pakicë, përpunimi i ushqimit, zejtari, hotelieri dhe shërbime hoteliere (restorante), aktivitete bankare dhe shërbime financiare, sigurime dhe veprimtari tjera afariste.
- b) llojit të lokalit në të cilin ushtrohet veprimtaria afariste, si p.sh., dyqanet, tezgat ose kioskat.
- c) shitjes së pijeve që përmbajnë alkool.

10.4 Rregullorja e sipërpërmendur komunale nuk mund të përcaktojë taksa të ndryshme për marrjen e lejes për ushtrimin e veprimtarisë afariste në bazë të:

- a) numrit të punëtorëve të shoqërisë përkatëse tregtare;
- b) vëllimit të veprimtarisë afariste të shoqërisë tregtare, qoftë përmes qarkullimit, prodhimtarisë ose cilitdo tregues tjetër të ngjashëm;
- c) përmasave të hapësirës e cila përdoret nga shoqëria tregtare;
- d) lokacionit në të cilin ushtrohet veprimtaria afariste; dhe
- e) të hyrave, përfitimeve ose qarkullimit me para të gatshme të shoqërisë tregtare.

10.5 Taksa për lejen e ushtrimit të veprimtarisë afariste caktohet për secilin lokacion ku ushtrohet një veprimtari afariste brenda kufijve të komunës. Nëse një shoqëri tregtare ushtron veprimtarinë afariste në më shumë se një lokacion në një komunë, atëherë një leje për ushtrimin e veprimtarisë mund të kërkohet për secilin lokacion të këtyllë.

10.6 Para dhënies së lejes për ushtrimin e veprimtarisë afariste për një shoqëri tregtare, Komuna duhet të kërkojë prova të shkruara për të vërtetuar nëse kjo shoqëri tregtare është e regjistruar në Regjistrin e Bizneseve të Kosovës.

10.7 Rregulloret komunale do të kërkojnë që lejet për ushtrimin e veprimtarisë afariste të ekspozohen publikisht në lokacionin për të cilin është dhënë leja.

10.8 Komuna nuk do t'i lejojë asnjë personi ose ndërmarrje e cila nuk është e regjistruar në Regjistrin e Bizneseve të Kosovës që të ushtrojë veprimtari afariste brenda komunës, përveç kur personi ose ndërmarrja dëshmon se në bazë të Ligjit për Shoqëritë Tregtare ata janë të liruar nga ky regjistrim.

## **Neni 11**

### **Taksa për Lejen për Shërbime Profesionale**

11.1 Përmes një rregulloreje komunale, komuna mund të kërkojë nga shoqëritë tregtare të cilat tashmë janë të regjistruara në Regjistrin e Bizneseve të Kosovës dhe të cilat ofrojnë shërbime profesionale në lokalit të cilat ndodhen brenda komunës, që të marrin një leje për ushtrimin e shërbimeve profesionale ("leja për shërbime profesionale").

11.2 Përmes një rregulloreje komunale, komuna gjithashtu mund të caktojë një taksë vjetore e cila duhet të paguhet për marrjen ose mbajtjen e lejes së sipërpërmendur. Rregullorja e sipërpërmendur mund të vendosë një skemë tarifore e cila përcakton taksat e ndryshme për kategoritë e ndryshme të shërbimeve profesionale. Të gjitha taksat për marrjen e lejes për shërbime profesionale duhet të caktohen vetëm në bazë të rregullave të përcaktuara në rregulloren komunale.

11.3 Leja për shërbime profesionale për kontabilistë, avokatë, mjek, stomatolog dhe profesione të tjera do të lëshohet vetëm pasi që aplikuesi të paraqesë prova të shkruara mbi licencën dhe/ose certifikatën

zyrtare për ushtrimin e veprimtarisë në përputhje me kushtet e aplikueshme ligjore të përcaktuara ose në bazë të ligjeve të Republikës së Kosovës.

11.4 Lëshimi i lejes për shërbime profesionale nga komuna nuk përbën gjykim nga komuna lidhur me përshtatshmërinë e poseduesit të lejes për ushtrimin e profesionit përkatës.

## **Neni 12** **Taksa për Automjetet Motorike**

12.1 Komuna ka të drejtë që të kërkojë nga personat fizik të cilët janë banorë të komunës përkatëse si dhe nga shoqëritë tregtare dhe ndërmarrjet e tjera selia e të cilave në Kosovë ndodhet në komunën përkatëse që të paguajnë një taksë vjetore për automjete motorike (taksa për automjete motorike) për secilin automjet i cili është në pronësi të banorit, shoqërisë tregtare ose ndërmarrjes së sipërpërmendur.

12.2 Komuna nuk do të vendosë taksën për automjetet motorike të cilat janë në pronësi të personave fizik që nuk janë banorë të komunës ose shoqëritë tregtare ose ndërmarrjet selia e të cilave në Kosovë nuk është e vendosur në atë komunë.

12.3 Nëse komuna vendos që të caktojë këtë taksë për automjete motorike, kuvendi komunal do të nxjerrë një rregullore për këtë qëllim. Taksa për automjetet motorike përcaktohet në bazë të fuqisë motorike të automjetit motorik dhe/ose llojit të automjetit (motoçikletë, automobil për udhëtarë, kamion ose autobus).

12.4 Përmes një rregulloreje, kuvendi komunal mund të bëjë përjashtimin nga kjo taksë ose reduktimin e taksës për automjetet të cilat përdoren (i) nga shërbimet emergjente, (ii) për transportimin e personave me aftësi të kufizuara, dhe (iii) për qëllime të tjera domethënëse shoqërore ose publike.

## **Neni 13** **Taksat Administrative Komunale**

13.1 Përmes një rregulloreje, komuna mund të vendosë një skemë tarifore për taksat të cilat caktohen për shërbimet të cilat u ofrohen personave nga komuna.

13.2 Asnjë taksë e këtyre shërbimeve administrative komuna nuk mund të përcaktohet në një nivel i cili e tejkalon koston për ofrimin e këtyre shërbimeve, duke përfshirë koston e punës dhe koston për shfrytëzimin e materialeve dhe pajisjeve.

13.3 Taksat administrative komunale janë të veçanta nga taksat për lëshimin e licencave, lejeve, dokumenteve.

## **Neni 14** **Taksat për Lejet për Ndërtimin dhe Rrënimin e Ndërtesave dhe Strukturave të Tjera**

14.1 Përmes një rregulloreje, komuna mundet (i) të kërkojë nga një person i cili dëshiron të bëjë ndërtimin ose rrënimin e një ndërtese ose strukture tjetër brenda komunës që të marrë leje për këtë qëllim, dhe (ii) të përcaktojë një skemë tarifore për këto leje e cila vendos taksa të ndryshme në bazë të sipërfaqes në të cilën ndodhet ose në të cilën do të ndërtohet ndërtesa ose struktura.

14.2 Shpenzimet për aktivitetet e inspektimit ose të mbikëqyrjes të cilat komuna duhet t'i ushtrojë në bazë të ligjit ose rregullores në lidhje me aktivitetet e ndërtimit ose të rrënit, mund të ngarkohen në formë të taksës për shërbime administrative komunale sipas Nenit 13.

## **Neni 15** **Taksat tjera Komunale**



Komuna mund të përcaktojë dhe të vjelë taksa në aktivitete të tjera, duke përfshirë si vijon:

- a) parkimin e automjeteve në pronën komunale, duke përfshirë trotuaret dhe rrugët;
- b) shfrytëzimin e pronës komunale për rekreacion, duke përfshirë kampingun;
- c) për gjueti ose peshkim brenda kufijve të komunës dhe në pronën e komunës;
- d) për marketing ose ekspozita të tjera në pronën e komunës;
- e) për ceremonitë ose funksionet e tjera të cilat ushtrohen nga zyrtarët komunal; p.sh. për kurorëzime; dhe
- f) taksa të tjera komunale të cilat përcaktohen me anë të legjislacionit komunal.

#### **Neni 16**

#### **Taksat për Lëshimin e Certifikatave dhe Dokumenteve Zyrtare**

16.1 Përmes një rregulloreje, komuna mund vendosë taksa të cilat zbatohen për lëshimin e (i) certifikatave ose dokumenteve të tjera të lindjes, siç janë certifikatat e kurorëzimit, lindjes, shkurorëzimit, gjendjes ekonomike dhe sociale dhe certifikata tjera të ngjashme, dhe (ii) kopje të këtyre certifikatave dhe dokumenteve tjera origjinale, duke përfshirë kopje të dokumenteve zyrtare të cilat duhet të vihen në dispozicion të publikut sipas ligjeve të Republikës së Kosovës.

16.2 Asnjë taksë e këtillë nuk mund të përcaktohet në një nivel i cili e tejkalon koston për sigurimin e certifikatës ose kopjes përkatëse.

### **KREU III**

#### **Taksat, Rentat, Gjobat, Bashkë pagesat dhe të hyrat e Tjera Vetanake Komunale**

#### **Neni 17**

#### **Tarifat Rregullative për Zhvillimin ose Ruajtjen e Infrastrukturës**

17.1 Përmes një rregulloreje, komuna mund të vendosë tarifa të cilat caktohen me qëllim të kompensimit të shpenzimeve të komunës për ndërtimin, përmirësimin, zgjerimin ose riparimin e infrastrukturës komunale, nëse këto masa bëhen të nevojshme si pasojë e drejtpërdrejtë e (i) ndërtimit të ndërtesave të reja ose (ii) zgjerimit ose rehabilitimit të konsiderueshëm të ndërtesave ekzistuese.

17.2 Nëse ndërtimi, zgjerimi ose rehabilitimi i sipërpërmendur shkakton rritjen e numrit të njësive banuese në komunë, komuna mundet, përmes një rregulloreje, të vendosë tarifa të cilat duhet të paguhen për shkak të ndikimit që ka kjo rritje e popullsisë në shërbimet arsimore, shëndetësore dhe shërbimet e tjera të cilat ofrohen nga komuna.

#### **Neni 18**

#### **Gjobat në Trafik**

18.1 Përmes një rregulloreje, komuna do të vendosë rregullat të trafikut dhe të përcaktojë gjobat të cilat shqiptohen në rast të shkeljes së këtyre rregullave. Të gjitha rregullat komunale të trafikut duhet të jenë në përputhshmëri me rregullat e përcaktuara në ligjet e Republikës së Kosovës.

18.2 Gjobat e shqiptuara për shkeljet në trafik brenda territorit të komunës janë të hyra vetanake të komunës. Transferet do të bëhen në përputhje me LMFPP dhe do të përfshijnë pagesat të cilat bëhen përmes Shërbimit Policor të Kosovës dhe gjykatave si rezultat i vendimeve gjyqësore.

#### **Neni 19**

## **Gjobat për Shkeljen e Rregulloreve Komunale**

19.1 Komunat mund të shqiptojnë gjoba dhe masa të tjera për shkeljet e rregulloreve komunale të miratuara nga kuvendi komunal. Shuma specifike e këtyre gjobave dhe/ose ashpërsia e masave detyimore duhet të jetë proporcionale me seriozitetin e shkeljes dhe në kuadër të tyre duhet të përfshihen edhe shpenzimet e nevojshme ligjore, juridike dhe administrative për mbledhjen e gjobës dhe/ose zbatimin e masës.

19.2 Përmes një rregullore, komuna do të shqiptojë gjoba për personat privat të cilët pengojnë ose kufizojnë, ose tentojnë të pengojnë ose kufizojnë, qasjen e publikun në pronën komunale, përmes ndërtimit ose vendosjes së pa autorizuar të barrierave, pengesave ose shenjave të përkohshme ose të përhershme.

## **Neni 20 Të hyrat nga qiradhënia**

20.1 Komunat kanë të drejtë të vendosin dhe mbledhin qiranë për shfrytëzimin e pronës komunale nga ndërmarrjet ose personat fizik.

20.2 Përveç sikur që është përcaktuar në paragrafin 6 të këtij neni vlera e qirasë për shfrytëzimin e pronës komunale është vlera e tregut.

20.3 Vlera e qirasë për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme komunale është vlera e tregut e cila bazohet në (i) madhësia e ndërtesës ose tokës e matur me metër katror ose ndonjë matje tjetër e sipërfaqes, (ii) vendndodhja dhe lloji i ndërtesës ose tokës, dhe (iii) qëllimi i shfrytëzimit, qoftë për ushtrimin e aktiviteteve afariste, tregtisë, banimit, bujqësisë ose punëve profesionale.

20.4 Komunat mund të vendosin dhe mbledhin qiranë nga shoqëritë tregtare të cilat shfrytëzojnë pronën e komunës për ushtrimin e aktiviteteve të tyre, duke përfshirë – mirëpo pa u kufizuar – kioskat, tavolinat për shitje dhe restorantet të cilat janë të vendosura ose bëjnë shfrytëzimin e trotuareve, rrugëve, lehtësirave (komoditeteve) publike, tokës komunale ose pronave të tjera komunale.

20.5 Vlera e qirasë nuk përcaktohet në bazë të të ardhurave ose shitjes së shoqërisë tregtare e cila bën shfrytëzimin e pronës komunale.

20.6 Komuna mund të përcaktojë një vlerë të qirasë e cila është më të ulët se ajo e tregut nëse shfrytëzimi i propozuar i pronës komunale në mënyrë të qartë i shërben një qëllimi domethënës shoqëror ose publik i cili është përcaktuar si i këtillë sipas një rregullore të miratuar nga kuvendi komunal.

## **Neni 21 Bashkë pagesat për Arsim dhe Shëndetësi**

21.1 Të gjitha bashkë pagesat, tarifrat dhe taksat për shërbimet komunale shëndetësore konsiderohen si të hyra vetanake të komunës; megjithatë, këto shuma gjithashtu janë të hyra të dedikuara të institucionit përkatës shëndetësor. Fjalja e mësipërme zbatohet në mënyrë të pavarur nga dispozitat e tjera të këtij ligji të cilat e rregullojnë shfrytëzimin e të hyrave vetanake. Trajtimi, kontabiliteti, raportimi, monitorimi dhe verifikimi i këtyre bashkë pagesave, tarifave dhe taksave do të bëhet në përputhje me LMFPP.

21.2 Të gjitha bashkë pagesat, tarifrat, taksat dhe pagesat për shkollim në shërbimet komunale arsimore konsiderohen si të hyra vetanake të komunës; megjithatë, këto shuma gjithashtu janë të hyra të dedikuara të institucionit përkatës arsimor. Fjalja e mësipërme zbatohet në mënyrë të pavarur nga dispozitat e tjera të këtij ligji të cilat e rregullojnë shfrytëzimin e të hyrave vetanake. Trajtimi, kontabiliteti, raportimi, monitorimi dhe verifikimi i këtyre bashkë pagesave, tarifave dhe taksave do të bëhet në përputhje me LMFPP.

## **Neni 22**

### **Të hyrat e tjera vetanake**

Të hyrat vetanake të autorizuar në bazë të këtij ligji nuk janë gjithëpërfshirëse. Komunitet mund të vjelin dhe mbledhin të hyra të tjera të cilat u lejohen në bazë të një ligji ose në bazë të marrëveshjes me autoritetet qendrore.

## **PJESA III**

### **Grantet Operative dhe Barazimi**

#### **Neni 23**

##### **Grantet Operative**

23.1 Komunitet pranojnë Grante Operative nga BKK. Grantet Operative janë: (i) Grantet e Përgjithshme, (ii) Grantet Specifike për Arsim dhe (iii) Grantet Specifike për Shëndetësi. Grantet duhet të bazohen në kritere të drejta, transparente dhe objektive duke ju dhënë kështu komunitet pavarësi më të madhe në alokimin dhe shpenzimin e këtyre granteve.

#### **Neni 24**

##### **Granti i Përgjithshëm**

24.1 Komunitet kanë të drejtë të pranojnë një Grant të Përgjithshëm të cilin mund ta shfrytëzojnë për ushtrimin e kompetencave të tyre komunale në përputhje me ligjet e zbatueshme në Kosovë. Granti i Përgjithshëm (i) mundëson një shkallë të arsyeshme të stabilitetit në të hyrat komunale, (ii) ofron një mjet adekuat për vendosjen e barazisë ndërmjet komunitet, (iii) duhet të marrë parasysh mundësinë e banorëve të secilës komunitet për të pasur qasje në shërbimet publike, dhe (iv) mundëson alokimin adekuat të burimeve për komunitetet pakicë në komunitet përkatëse.

24.2 Shuma e Grantit të Përgjithshëm është dhjetë përqind (10%) e të hyrave totale të buxhetuara të qeverisë qendrore, duke përfshirë (i) të hyrat nga shitja e pasurive, (ii) të hyrat e tjera të jashtëzakonshme, (iii) të hyrat e dedikuara, dhe (iv) të hyrat nga huamarrja.

24.3 Me qëllim të nivelizimit të kapacitetit të ulët të të hyrave vetanake të komunitet më të vogla, nga totali i Grantit të Përgjithshëm, secila komunitet do të pranojë një shumë të përgjithshme (paushallë) prej 140,000 € në vit, minus 1€ për kokë banori, ose 0€ për komunitet me popullsi të barabartë ose më të madhe se 140,000.

24.4 Pjesa e mbetur e Grantit të Përgjithshëm u alokohet komunitet në përpjesëtim me: (i) numrin e popullsinë, (ii) numrin e popullsisë pakicë, (iii) nëse shumica e popullsisë përbëhet nga pakica kombëtare; dhe (iv) madhësia gjeografike.

24.5 Popullsia llogaritet me tetëdhjetë e nëntë përqind (89%); numri i popullsisë pakicë me tre përqind (3%); komunitet, shumica e popullsisë së të cilave përbëhet nga pakicat kombëtare me dy përqind (2%); dhe përmasat gjeografike me gjashtë përqind (6%).

24.6 Të dhënat mbi popullsinë, madhësinë gjeografike dhe pakicat të cilat duhet të shfrytëzohen për llogaritjen e përqindjeve janë paraqitur në Shtojcën 1 të këtij ligji.

#### **Neni 25**

##### **Grantet Specifike për Arsim dhe Shëndetësi**

25.1 Komunat do të pranojnë një Grant Specifik për Arsim dhe një Grant Specifik për Shëndetësi. Përcaktimi i shumës së këtyre granteve bazohet në një qasje të hapur të financimit.

25.2 Granti Specifik për Arsim përdoret për financimin e kostos së ofrimit të nivelit të standardit minimal të arsimit parashkollor, fillor dhe të mesëm.

25.3 Granti Specifik për Shëndetësi përdoret për financimin e kostos së ofrimit të nivelit të standardit minimal të shëndetësisë publike primare.

25.4 Granti Specifik për Arsim përcaktohet dhe u alokohet komunave në përputhje me formulën e përcaktuar nga Komisioni i Granteve. Kjo formulë bazohet në numrin e regjistruar të nxënësve dhe standardet të siguruara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Kjo formulë kryesisht bazohet në numrin e normalizuar të mësimdhënësve dhe regjistrimin. Formula gjithashtu do të marrë parasysh programin mësimor kombëtar, arsimin për nevoja të veçanta, shpenzimet operative që nuk përfshijnë pagat, normat e madhësisë së klasave dhe lokacioni. Nxënësve minoritar do t'u kushtohet rëndësi e veçantë.

25.5 Granti Specifik për Shëndetësi do të përcaktohet dhe do t'u alokohet komunave në përputhje me formulën e përcaktuar nga Komisioni i Granteve. Kjo formulë do të bazohet në popullsinë e normalizuar dhe standardet e vendosura nga Ministria e Shëndetësisë. Normalizimi merr parasysh moshën dhe strukturën gjinore të popullsisë së regjistruar të ofruesit të shëndetësisë primare si dhe numrin e personave të moshuar dhe personave me nevoja të veçanta shëndetësore.

## **PJESA IV Grantet dhe Transferet e Tjera**

### **Neni 26 Transferet për Kompetencat e Deleguara**

Kur kompetencat Qeveritare u delegohen komunave, komunat përkatëse do të pranojnë financim nga BKK përmes transfereve nga ministritë përkatëse për ushtrimin e këtyre funksioneve. Ky financim është i veçantë nga Grantet Operative dhe duhet të bëhen në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji.

### **Neni 27 Grantet për Kompetencat e Shtuara**

Kur kompetencat vetanake të komunave shtohen në bazë të ligjit, komunat përkatëse do të pranojnë grante nga BKK për financimin e ushtrimit të këtyre kompetencave të shtuara. Këto grante janë të veçanta nga Grantet Operative dhe epen në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 6 të këtij ligji. Komuna është e detyruar t'i shpenzojë këto grante vetëm për çështjet të cilat në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë ndërlidhen me kompetencat e shtuara.

### **Neni 28 Autorizimi për Shpenzim dhe Monitorimi**

28.1 Autorizimi për shpenzimin e mjeteve të transferuara për kompetencat e deleguara dhe për grantet e dhëna për kompetencat e shtuara i takon komunës pranuese, e cila duhet të veprojnë në përputhje me dispozitat e aplikueshme të LMFPP gjatë ushtrimit të këtij autorizimi.

28.2 Ministritë përgjegjëse për fushën përkatëse të cilës i takojnë kompetencat e deleguara ose të shtuara do bëjnë monitorimin dhe do të sigurojnë që (i) këto kompetenca të ushtrohen në përputhje me ligjet, aktet nënligjore dhe standardet përkatëse, dhe (ii) masat e marra nga komuna për ushtrimin e këtyre kompetencave të jenë të duhura. Ministritë përkatëse do t'i sigurojnë një raport vjetor të monitorimit Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave dhe Ministrisë së Pushtetit Lokal mbi këto çështje.

**Neni 29**  
**Grantet e Jashtëzakonshme**

Në rast se një fatkeqësi natyrore ose një kryengritje civile, lufta kundër terrorizmit ka ndikim serioz në një komunë, Qeveria duhet t'i ndajë një grant të jashtëzakonshëm komunës me qëllim të lehtësimit të pjesshëm ose të plotë të barrës që vendos kjo ndodhi në buxhetin e komunës.

**PJESA V**  
**Huamarrja Komunale dhe Zotimet**

**Neni 30**  
**Huamarrja Komunale dhe Zotimet Afatgjate**

30.1 Deri në kohën e miratimit të legjislationit mbi huamarrjen dhe borxhin kombëtar, huamarrja nga komunat rregullohet në bazë të këtij neni.

30.2 Komunat do të kenë qasje në financim të borxhit për investime kapitale në përputhje me kushtet e përcaktuara në këtë nen.

30.3 Në bazë të kërkesës nga kryetari i komunës e cila është miratuar nga kuvendi komunal, Ministri i Ekonomisë dhe Financave mund të autorizojë huamarrjen nga komuna. Kërkesa duhet të përmbajë dispozita të cilat trajtojnë çështjet në vijim:

- a) që nuk është kontraktuar borxh ndërkombëtar;
- b) huamarrja do të lejohet vetëm nga tregu kombëtar i kapitalit dhe pa ekspozim ndaj riskut nga këmbimet e huaja;
- c) të hyrat nga huamarrja do të përdoren për projekte të posaçme të investimit kapital të cilat janë paraparë në KAMSH dhe janë autorizuar në BKK;
- d) projektet e investimit kapital duhet t'i jenë nënshtruar një rishikimi të suksesshëm të planeve të investimit dhe planeve kapitale nga Komisioni i Granteve;
- e) kushtet e propozuara të huamarrjes duhet të jenë shqyrtuar dhe miratuar si të krahasueshme me kushtet e tregut nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave;
- f) e ashtuquajtura "periudha e pritjes" e cila aplikohet për marrëveshjet për huazim, me anë të të cilës shlyerja e borxhit pezullohet ose lehtësohet për një periudhë fillestare, është e ndaluar;
- g) të gjitha huamarrjet e propozuara duhet të jenë të mbuluara plotësisht me kolateral me prona të paluajtshme në pronësi të komunës. Prona e paluajtshme e cila përdoret si kolateral duhet të jetë në pronësi të komunës dhe të jetë e lirë nga të gjitha pretendimet e tjera pronësore apo pengesat.
- h) përcaktimi i vlerës së pronës së paluajtshme e cila vihet peng si kolateral (sikur që është përshkruar në pikën g) më sipër duhet të jetë miratuar nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave.
- i) shërbimi i përgjithshëm vjetor i borxhit, duke përfshirë kamatën dhe pagesat themelore për shlyerjen e borxhit të papaguar të komunës dhe e cila duhet të përfshijë shumën e huamarrjes së re të propozuar, nuk duhet të tejkalojë pesëmbëdhjetë përqind (15%) të totalit të të hyrave vetanake të komunës nga viti i kaluar fiskal.
- j) shuma e përgjithshme e borxhit të papaguar të komunës, duke përfshirë huamarrjen e propozuar, nuk duhet të tejkalojë pesëdhjetë përqind (50%) të të hyrave vetanake komunale që nga vitit i shkuar fiskal; dhe
- k) pasi që komuna të ketë lidhur marrëveshjen për huamarrje, kopje të të gjitha dokumenteve duhet t'i dërgohen Ministrisë të Ekonomisë dhe Financave.

30.4 Me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë dhe Financave, Qeveria është e autorizuar që të suspendojë zbatimin e paragrafit 1 të këtij neni për shkak të konsideratave makroekonomike për një periudhë e cila nuk i tejkalon katër vite.

30.5 Kontratat e qirasë dhe të gjitha aranzhimet e ngjashme financiare të cilat paguhen me këste gjatë një periudhë kohore duhet të miratohen paraprakisht nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave. Kosto

vjetore e këtyre aranzhimeve financiare trajtohet si borxh dhe shprehimisht i nënshtrohet kufizimeve të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni si dhe trajtohet si shërbim i borxhit për qëllime të pikave (i) dhe (j) të atij neni.

30.6 Kufizimet e parapara në LMFPP për dhënien e granteve, dhuratave, donacioneve ose subvencioneve për cilindo person ose ndërmarrje zbatohen për komunat.

## **PJESA VI**

### **Dispozitat Institucionale dhe Komisioni i Granteve**

#### **Neni 31**

##### **Dispozitat mbi Grantet Operative**

31.1 Gjatë përgatitjes së propozim Ligjit Vjetor për Ndarjet Buxhetore për vitin e ardhshëm fiskal, Ministri i Ekonomisë dhe Financave, në propozim-ndarjet buxhetore për komunat, duhet të përcaktojë shumat të cilat rekomandohet t'u ndahen komunave si Grante Operative. Gjatë propozimit të shumës së këtyre granteve, Ministri do të përdorë formulën e përcaktuar në këtë ligj.

31.2 Një grant i përgjithshëm mund të shfrytëzohet nga komuna për çfarëdo qëllimi që ndërlidhet me ushtrimin e kompetencave komunale. Pavarësisht nga e mësipërmja, Ministri i Ekonomisë dhe Financave mund të nxjerrë udhëzime të përgjithshme për shpenzimet aktuale dhe kapitale të cilat duhet të zbatohen nga komunat.

31.3 Nëse gjatë bashkërendimit përfundimtar nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave të buxhetit për një vit të caktuar fiskal konstatohet se të hyrat faktike i tejkalojnë të hyrat e buxhetuara për më shumë se pesë përqind (5%), atëherë shuma e të hyrave tepricë do t'u ndahet komunave në mënyrë të njëjtë si ajo që është përcaktuar në paragrafin 2 të nenit 24 të këtij ligji. Ministri i Ekonomisë dhe Financave pastaj do (i) të rregullojë nivelet e Granteve të Përgjithshme për secilën komunë në përputhje me formulën e përcaktuar në paragrafin 5 të nenit 24 të këtij ligji, dhe (ii) të iniciojë procesin e zakonshëm të buxhetimit dhe ndarjeve buxhetore në përputhje me LMFPP.

#### **Neni 32**

##### **Komisioni i Granteve: Anëtarësia, Organizimi, Takimet**

32.1 Komisioni i Granteve themelohet në bazë të këtij ligji dhe ka përbërjen në vijim: (i) Kryeministri ose përfaqësuesi i tij, (ii) Ministri i Ekonomisë dhe Financave, (iii) Ministri i Pushtetit Lokal, (iv) një ministër tjetër i caktuar nga Qeveria, (v) Kryesuesi i Komisionit për Buxhet të Kuvendit, dhe (vi) katër kryetarë të komunave, njëri ndër të cilët duhet të jetë kryetari i një komune minoritare. Kryetarët e komunave zgjedhën përmes shortit sikur që është paraparë në paragrafin 2 të këtij neni.

32.2 Zgjedhja e kryetarëve të komunave bëhet përmes dy shorteve të veçanta, të cilat mbahen në bazë vjetore nga Komisioni i Granteve në një takim të hapur. Përveç sikur që është përcaktuar në paragrafin 3 të këtij neni, Komisioni i Granteve i mban këto shorte në mbledhjen e tij të fundit të secilit vit kalendarik. Në njërin short përfshihen vetëm emrat e komunave shumicë ndërsa në tjetrën vetëm emrat e komunave pakicë. Emrat e tri komunave zgjedhën në shortin e parë dhe emri i një komune pakicë zgjidhet në shortin e dytë. Emrat e komunave të cilat janë të përfaqësuara në Komisionin e Granteve gjatë kësaj kohë nuk përfshihen në cilindo short i cili mbahet për zgjedhjen e kryetarëve të komunave të cilët do të shërbejnë në Komisionin e Granteve gjatë vitit të ardhshëm. Kryetarët e komunave të zgjedhura do të shërbejnë në Komisionin e Granteve gjatë vitit të ardhshëm kalendarik.

32.3 Mandati i Komisionit të Granteve i cili ekziston në kohën e shpalljes së këtij ligji skadon në mesnatën e ditës së 30 kalendarike pas shpalljes së këtij ligji. Gjatë kësaj periudhe 30 ditore, Komisioni ekzistues i Granteve do të mbajë shortet e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni në një takim të hapur për zgjedhjen e kryetarëve të komunave të cilët do të shërbejnë në Komisionin e ri të Granteve. Nëse Komisioni ekzistues i Granteve dështon t'i mbajë këto shorte gjatë periudhës së sipërpërmendur 30 ditore, atëherë Qeveria menjëherë do t'i mbajë shortet. Kryetarët e komunave të cilët zgjidhen në këto

shorte do të shërbejnë në Komisionin e Granteve deri në fund të vitit kalendarik në të cilin ata janë zgjedhur. Pasardhësit e tyre zgjedhën sipas paragrafit 2 të këtij neni.

32.4 Komisioni i granteve mban takime të rregullta të cilat thirren nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave, së paku një herë në çdo tremujor kalendarik. Takimet e tjera mund të thirren së bashku nga dy anëtarë, me kusht që të gjitha këto takime të jo të rregullta të thirren së paku shtatë ditë para mbajtjes së tyre. Takimi i Komisionit të Granteve mund të mbahet ose të vazhdohet në mënyrë të vlefshme vetëm nëse gjashtë ose më shumë anëtarë janë të pranishëm dhe Ministri i Ekonomisë dhe Financave ose Kryeministri është ndër të pranishmit. Nëse Kryeministri është personalisht i pranishëm, ai e kryeson takimin e Komisionit të Granteve, e nëse jo, atëherë takimin e kryeson Ministri i Ekonomisë dhe Financave.

32.5 Ministri do të sigurojë një sekretariat të përhershëm për përkrahjen e Komisionit të Granteve. Fondet e nevojshme për punën e Komisionit të Granteve do të sigurohen nga buxheti i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Ministri i Ekonomisë dhe Financave do të kryejë, ose të aranzhojë kryerjen, e të gjitha veprimtarive të ekspertizës dhe/ose administrative-teknike ose analizave të cilat në mënyrë të arsyeshme nevojiten nga Komisioni i Granteve.

32.6 Kuorumi prej së paku gjashtë anëtarëve nevojitet në mënyrë që një çështje të hedhet në votim. Nëse Komisioni i Granteve nuk mund të vendosë mbi një çështje të caktuar me shumicë votash, kjo çështje do të vendoset nga Kryeministri ose nëse Kryeministri nuk është personalisht i pranishëm në takim -Ministri i Ekonomisë dhe Financave.

32.7 Të gjitha vendimet dhe rekomandimet e miratuara nga Komisioni i Granteve publikohen në faqen e internetit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave. Komisioni i Granteve, mundet, me shumicë votash, të dakordohet që t'i mbajë diskutimet mbi një çështje të caktuar në mënyrë konfidenciale.

### **Neni 33** **Komisioni i Granteve: Përgjegjësitë**

Komisioni i Granteve i cili është themeluar në bazë të këtij ligji ka këto përgjegjësi:

- a) të bëjë shqyrtimin e formulës për ndarjen e granteve të përcaktuar në këtë ligj 2 vite pas shpalljes së këtij ligji dhe pastaj së paku çdo tri (3) vite, si dhe t'i rekomandojë Qeverisë propozim ndryshime dhe plotësime për këtë formulë, e cila më pas i'a përcjell Kuvendit rekomandimet e Komisionit të granteve së bashku me pëlqimin e Qeverisë ose arsyet për refuzimin e rekomandimeve nga Qeveria;
- b) në bazë vjetore të përcaktojë formulën për ndarjen e Grantit Specifik për Arsim dhe Grantit Specifik për Shëndetësi në përputhje me parimet e parashtruara në nenin 25 të këtij ligji;
- c) deri më 31 Mars të çdo viti kalendarik, të përgatisë dhe t'i dorëzojë Qeverisë një raport për vitin e shkuar kalendarik në të cilin bëhet vlerësimi i përshtatshmërisë së sistemit financiar;
- d) të bëjë shqyrtimin e ankesave nga komunat lidhur me zbatimin e kësaj formule, duke përfshirë financimin e kompetencave të deleguara ose të shtuara, si dhe t'i rekomandojë Qeverisë propozim-masa në këtë drejtim;
- e) të përgatisë rekomandime për alokimin e shumave plotësuese (shtesë) ato komuna të cilave i'u janë dhënë kompetenca të shtuara sipas neneve 19 deri 22 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, për t'u mundësuar këtyre komunave ushtrimin e rregullt të kompetencave të tyre të shtuara;
- f) të bëjë monitorimin e zbatimit të nenit 34 të këtij ligji dhe të përgatisë rekomandime për arritjen e qëllimeve të atij neni;
- g) të monitorojë miratimin e të dhënave pas regjistrimit të popullsisë si dhe zbatimin e klauzolës së mos dëmtimit, në përputhje me nenin 35 të këtij ligji, si dhe të përgatisë rekomandimet për arritjen e qëllimit të atij neni;
- h) të bëjë shqyrtimin e propozim shpenzimeve kapitale të buxhetuara për komunat nga organizatat buxhetoere të Qeverisë së Kosovës, të cilat i dorëzohen Komisionit nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave, si dhe të përgatisë rekomandime për Qeverinë lidhur me këtë;
- i) të bëjë shqyrtimin e kërkesave nga komunat për financim shtesë për përmbushjen e nevojave të jashtëzakonshme, si dhe t'i rekomandojë Qeverisë masa në këtë drejtim; dhe

- j) të mbështesë Ministrin e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministrin e Pushtetit Lokal si dhe autoritetet e tjera publike në sigurimin e zbatimit të këtij ligji.

## **PJESA VII Dispozitat Kalimtare dhe Përfundimtare**

### **Neni 34 Grantet Minimale për VF 2009**

Nëse gjatë vitit të parë të zbatimit të sistemit të granteve të themeluar në bazë të këtij ligji, shuma e përgjithshme e Granteve Operative për një komunë, e llogaritur në bazë të këtij ligji, është më e ulët se shuma e përgjithshme e granteve të vitit të kaluar, atëherë shuma e përgjithshme e këtyre Granteve Operative do të jetë e barabartë me shumën e përgjithshme të të gjitha granteve të pranuar nga komuna gjatë vitit të kaluar fiskal, vetëm për komunën përkatëse dhe vetëm për vitin e parë të zbatimit të sistemit të ri.

### **Neni 35 Shfrytëzimi i të dhënave të reja mbi popullsinë**

35.1 Qeveria, pas rekomandimit nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave dhe Ministri i Pushtetit Lokal dhe me pëlqimin e PCN, mundet, gjatë vitit kalendarik 2008, të bëjë ndryshimin e Shtojcës 1 sikur që mund të jetë e nevojshme për përfshirjen e të dhënave të reja ose të ndryshuara mbi popullsinë.

35.2 Pas kësaj, nëse është e nevojshme për shkak të të dhënave të reja të cilat rrjedhin nga një regjistrim i ri i popullsisë, Qeveria do të bëjë ndryshimin e Shtojcës 1 për t'i inkuorporuar të dhënat nga ky regjistrim. Nëse të dhënat nga regjistrimi i popullsisë publikohen pas fillimit të një cikli të përgatitjes së buxhetit, Ministri i Ekonomisë dhe Financave mundet, mirëpo nuk është i detyruar, që t'i marrë parasysht këto të dhëna të reja gjatë atij cikli të përgatitjes së buxhetit.

35.3 Nëse shfrytëzimi i të dhënave të reja nga regjistrimi i popullsisë shkakton që shuma e një Granti Operativ për një komunë caktuar të jetë më e ulët se sa shuma për këtë grant e ndarë në vitin e kaluar, atëherë shuma e këtij granti do të jetë e barabartë me shumën e grantit të pranuar nga komuna përkatëse gjatë vitit të kaluar fiskal. Fondet e nevojshme për zbatimin e këtij paragrafi do të paguhen nga fondet plotësuese të BKK dhe jo nga shumatat e nevojshme për financimin e Granteve Operative.

### **Neni 36 Zbatimi, Aktet Nënligjore**

Ministria e Ekonomisë dhe Financave, në konsultim me Ministrinë e Pushtetit Lokal dhe sipas nevojës me Ministrinë e tjera, mund të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore për zbatimin e efektshëm të këtij ligji.

### **Neni 37 Hyrja në Fuqi**

37.1 Ky ligj e shfuqizon Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave Nr. 2007/2 mbi të Hyrat Vetanake të Komunave.

37.2 Ky Ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë ( 15 ) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës**

**Me datën : 13.03.2008**



## Shtojca I: Të dhënat për ndarjen e Granteve të Përgjithshme

	Popullsia	Madhësia gjeografike (km <sup>2</sup> )	Komunitetet pakicë Në Komunë	Komunat pakicë Në Kosovë
1 Deçan	40,400	297	294	
2 Dragash	35,000	430	12,935	
3 Ferizaj	111,000	345	3,367	
4 Fushë Kosovë	33,682	83	3,730	
5 Gjakovë	115,000	587	6,013	
6 Gjilan	100,348	392	4,058	
7 Illogovc	60,000	276	0	
8 Hani i Elezi (Kaçanik)	10,000	83	0	
9 Istog	44,000	454	2,646	
10 Junik (Deçan)	9,600	74	0	
11 Kaçanik	33,000	211	4	
12 Kamenicë	49,581	424	4,670	
13 Klinë	44,000	309	1,863	
14 Leposaviq	19,000	539	510	19,000
15 Lipjan	69,115	338	4,952	
16 Malishevë	52,000	306	28	
17 Mamusha (Prizren)	6,000	32	0	6,000
18 Mitrovicë (Jug)	90,000	331	0	
19 Novo Bërdë	9,899	204	2,785	9,899
20 Obiliq	26,000	105	3,360	
21 Pejë	115,000	603	12,650	
22 Podujevë	117,000	633	735	
23 Prishtinë	388,561	514	4,961	
24 Prizren	214,963	603	30,077	
25 Rahovec	63,000	278	1,953	
26 Shtërpcë	11,000	248	3,438	11,000
27 Shtime	28,000	134	560	
28 Skënderaj	56,000	374	366	
29 Suharekë	80,000	361	471	
30 Viti	46,458	270	293	
31 Vushtrri	75,000	345	2,615	
32 Zubin Potok	15,000	333	800	15,000
33 Zveçan	16,000	123	600	16,000
34 Graçanicë	18,642	131	2,670	18,642
35 Kllokot	4,542	23	1,205	4,542
36 Mitrovica e Veriut	20,000	5	1,990	20,000
37 Partesh	5,217	29	0	5,217
38 Ranillug	4,955	69	0	4,955
<b>Gjithsej</b>	<b>2,236,000</b>	<b>10,901</b>	<b>116599</b>	<b>130,255</b>